



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-025
Prishtinë, më 15 qershor 2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 15 QERSHOR
2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, Aida Dërguti, Slobodan Petroviq dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca, Donika Kadaj-Bujupi, Sasha Milosavljeviq dhe Valdete Bajrami.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi dhe Avni Bytyçi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe disa përfaqësues të organizatave dhe të Shoqërisë Civile dhe të tjerë, që i përcjellin punimet e Kuvendit.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe gjashtë (6) pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia e Kuvendit.

Më pas, Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 1 qershor 2015,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave,
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 1 qershor 2015

Adem Grabovci kërkoi që në evidencimin e diskutimit të tij, në transkript, në faqen 9, të hiqet fjalia: “Profesor Sabriu dhe Xhaviti janë alergjikë ndaj kishave”, ngase e ka thënë në shaka.

Kryesia e miratoi procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 1 qershor 2015.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet më 18 qershor 2015, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
4. *Interpelanca e ministrit të Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi lidhur me procesin e demarkacionit të kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi,*
5. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën e përgjithshme administrative,*
6. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës,*
7. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për patenta,*
8. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për markat tregtare,*
9. *Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,*
10. *Shqyrtimi i Raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2014,*
11. *Shqyrtimi i raportit të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2014,*
12. *Shqyrtimi i raportit të Agjencisë Kosovare për Prona për vitin 2014,*
13. *Shqyrtimi i raportit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2014,*
14. *Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me kontestet biznesore dhe adresimi i tyre në gjykata.*

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave:

1. Zgjedhja e Avokatit të Popullit

Kryesia këtë pikë e shtyu për mbledhjen e radhës.

2. Procedimi i Projektligjit për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e Projektligjit të lartshënuar, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me Projektligjin për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij, të hartuar nga deputeti Raif Qela, i mbështetur nga grupi i (47) deputetëve nënshkrues, si dhe ta përgatisë deklaratën e ndikimit buxhetor dhe deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afatin prej një muaji nga dita e pranimit.

3. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për kërkesat e Kuvendit të Kosovës për rishikimin e buxhetit për vitin 2015

Kryesia, pasi e shqyrtoi rekomandimin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

I. Miratohen kërkesat e Kuvendit të Kosovës për mjete shtesë në rishikim të buxhetit për vitin 2015, si në vijim:

1. Programi “Anëtarët e Kuvendit”, në kategorinë “Mallra dhe Shërbime”, të shtohet shuma prej 50 000 €.

2. Programi “Administrata e Kuvendit”, në kategorinë “Investime Kapitale”, të shtohet shuma prej 140 000€, për projektin “Modernizimi dhe Pajisja me Teknologji Digjitale për Sallën Plenare dhe sallat konferenciale”.

II. Miratohen kërkesat e Kuvendit të Kosovës për transferet e brendshme buxhetore në rishikim të buxhetit për vitin 2015, si në vijim:

a) Programi “Anëtarët e Kuvendit”, shuma prej 40 000 €, nga kategoria “Paga dhe Mëditje”, të transferohet në kategorinë “Subvencione dhe Transfere”.

b) Programi “Administrata e Kuvendit”, shuma prej 69 040 € nga kategoria “Mallra dhe Shërbime”, të transferohet në dy kategori tjera ekonomike:

- Në kategorinë “Shpenzime komunale”, në shumë prej 20 000€, dhe

- Në kategorinë “Investime Kapitale”, për projektin “Rifreskimi dhe Pavarësimi i TIK-ut”, në shumë prej 49 040€.

c) Programi “Stafi Mbështetës Politik”: shuma prej 21 000 €, nga kategoria “Paga dhe Mëditje”, të transferohet në kategorinë “Mallra dhe Shërbime”.

III. I rekomandohet Ministrisë së Financave që kërkesat e Kuvendit sipas pikës I dhe II të këtij vendimi t’i përfshijë në rishikimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

4. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës në bazë të Qarkores së parë buxhetore të Ministrisë së Financave 2016/01

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohen kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2016-2018.

2. Ministrisë së Financave i rekomandohet që të njëjtat kërkesa t'i përfshijë në linjat buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016-2018.

5. Kërkesa e deputetes Albulena Haxhiu, e mbështetur nga 15 deputetë nënshkrues, për debat parlamentar lidhur me veprimtarin e misionit të BE-së në Republikën e Kosovës.

Kryesia këtë pikë e shtyu për mbledhjen e radhës.

Pikat shitesë:

1. Kërkesa për lejim të mbajtjes së punëtorisë, prej 21-24 qershor 2015, në Durrës, Shqipëri

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i Grupit punues për hartimin e Projektligjit për Digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore, në këtë përbërje: Raif Qela, Blerim Grainca, Enver Hoti, Sadri Ferati, Xhevahire Izmaqi, Shqipe Pantina, Jelena Bontiq dhe zyrtarit nga stafi mbështetës i Komisionit, Armend Ademaj, si dhe një zyrtar i Administratës së Kuvendit për përkthim nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas, që do të mbahet në Durrës, Shqipëri, prej datës 21-24 qershor 2015.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe shpenzimet për ekspertin e angazhuar.

2. Kërkesa për lejimin e pjesëmarrjes në punimet e Pjesës së Tretë të Sesionit të rregullt të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, 21-26 qershor 2015, në Strasburg

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i delegacionit të Kuvendit të Kosovës, në këtë përbërje: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti, Slobodan Petroviqi dhe Valdete Bajrami, si dhe zyrtari për mbështetje të delegacionit nga protokoli i Administratës së Kuvendit, Shaban Selimi, për pjesëmarrjen në punimet e Pjesës së Tretë të Sesionit të rregullt të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, 21-26 qershor 2015, në Strasburg.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi, si dhe tejkalimin në bazë të rezervimit për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

3. Kërkesa për lejim e udhëtimit zyrtar të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, prej 17-19 qershor 2015, në Kroaci

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i anëtareve të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, në këtë përbërje: Jasmina Zhivković, Agim Qeku, Sasha Milosavljević, Rustem Berisha, Slavko Simić, Fisnik Ismaili, Danush Ademi, si dhe nga stafi mbështetës i Komisionit, Natasha Tisma, në Kroaci, prej 17-19 qershor 2015.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij Vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

4. Shqyrtimi i çështjeve të udhëtimeve zyrtare jashtë vendit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me çështjet e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit, mori këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të Kryesisë së Kuvendit për udhëtimet zyrtare jashtë vendit, nr. 03-V-094, datë 4 nëntor 2008

I. Pika 6 e vendimit të Kryesisë së Kuvendit për udhëtimet zyrtare jashtë vendit, nr. 03-V-094, datë 4 nëntor 2008, ndryshohet si në vijim:

1. Udhëtimin zyrtar të nëpunësve të Administratës së Kuvendit e lejon Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit. Sekretari paraprakisht e njofton Kryetarin e Kuvendit.

5. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Sllovaki

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i kryetarit të Komisionit për Punë të Jashtme, z. Enver Hoxhaj, në Sllovaki, prej datës 18-21 qershor 2015.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi për të lartshënuarin në pikën 1 (një) të këtij vendimi, mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

6. Propozimi për kompensimin e nëpunësit civil të Administratës së Kuvendit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Kryesia vendosi që të gjithë nëpunësit e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe stafi mbështetës politik të shpërblehen në formë bonusi për angazhim të shtuar në mbështetjen e organeve të Kuvendit (Kryesisë së Kuvendit, Seancës plenare dhe komisioneve parlamentare) për realizimin e Programit të punës së Kuvendit, për periudhën janar-qershor 2015.

Të ndryshme:

Nënkryetarja e Kuvendit, Aida Dërguti, dhe kryetarja e Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kada-Bujupi, e shtruan çështjen e kushteve të punës në zyrat ku janë të vendosura grupet e tyre parlamentare.

Ato theksuan se në zyrat, në Aneksin C, ku punojnë deputetët e grupeve të tyre parlamentare dhe i stafi mbështetës u mungojnë pajisjet e nevojshme teknike për punë, si dhe nuk funksion klima, Wireles-i dhe hapësirat e zyrave janë të vogla për punë në kushte normale.

Kryetari kërkoi nga Administrata e Kuvendit që t'i ndër marrë veprimet e nevojshme për t'i përmirësuar kushtet e punës për grupet parlamentare.

Kryetari e përfundoi mbledhjen e Kryesisë në orën 12:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale